



Prishtinë, 14 tetor 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1183_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Neni 15, Nenin 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, Nenin 30, Nenin 32 paragrafin 2 nënparagrafi 2.1, Nenin 34 dhe Nenin 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 6 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085)
- Dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.07/2017);
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Prodhimit të Energjisë Elektrike të dorëzuar në Rregullator me 24.02.2016 nga ndërmarrja "Kelkos Energy" SH.P.K., për HC Belaje, adresa: Rr. Demë Ali Pozhari, Nr. 41, 51000 Decan, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 14 tetor 2019, nxori këtë:

VENDIM

- I. LËSHOHET Licencë E PËRKOSSHME** për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga Hidrocentrali "Belaje" me kapacitet të instaluar 8.06 MW, ndërmarrjes "KelkosEnergy" SH.P.K, për periudhën nga 14.10.2019 deri me 13.10.2020, me numër licence ZRRE/Li_50/16.
- II. Obligohet** ndërmarrja "KelkosEnergy" SH.P.K, që brenda afatit të dhënë në pikën I të dispozitivit të këtij Vendimi, të sjellë në Rregullator Lejen Mjedisore të Integruar për gjeneratorin në fjalë, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- III. Afati i Licencës i dhënë në pikën I të dispozitivit të këtij Vendimi, do rishikohet dhe ndryshohet pas sigurimit të Lejes Mjedisore të Integruar të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në të kundërtën "KelkosEnergy" SH.P.K, nuk mund të operoj pa licencë.**
- IV. Obligohet** ndërmarrja të sjellë në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për "KelkosEnergy" SH.P.K, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës, përfshirë Marrëveshjen për Blerje të Energjisë Elektrike (MBA), të lidhur në mes ndërmarrjes "Kelkos Energy SH.P.K" dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT SH.A).



Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me 24.02.2016 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë nga Ndërmarrja "KelkosEnergy" SH.P.K, për hidrocentralin (HC) "Belaje", me kapacitet të instaluar prej 8.04 MW, në lokacionin e Luginës së Lumit Deçan, Komuna e Deçanit.
- Bordi i Rregullatorit (pas Kërkesës me shkrim nga "Kelkos Energy" SH.P.K) me datë 19 maj 2016 (V_813_2016) ka lëshuar vendim për modifikim të autorizimit final për HC Belaje, ku lejon ndryshim kapaciteti nga 9.02 MW në 8.06 MW.
- Ndërmarrja ka ndërtuar hidrocentralin "Belaje" me 8.06 MW përmes procedurës së autorizimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (shih Vendimin V_296_2010 mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar, Vendimin V_402_2012 për Lëshimin e Autorizimit (final) dhe Vendimin V_813_2016 për Modifikimin e Autorizimit Final).
- Pas ndërtimit të HC Belaje përmes procedurës së autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja në Kosovë, ndërmarrja "Kelkos Energy" SH.P.K ka aplikuar në Rregullator për marrje të licencës për operim dhe ka hyrë në operim, si fazë testuese.
- Ndërmarrja ka plotësuar kushtet për licencim, përveç Lejes Mjedisore dhe për këtë mbetet në proces të licencimit. Në pamundësi të marrjes Lejes Mjedisore nga MMPH, "Kelkos Energy" SH.P.K ka dorëzuar në Rregullator Pëlqimin Mjedisor për HC Belaje si dhe ka vazhduar operimin nga ky gjenerator. Njëkohësisht ka informuar Rregullatorin se do të dorëzojnë në Rregullator edhe Lejen Mjedisore të Integruar sapo të njëjtën ta nxjerr nga MMPH.
- Meqë "Kelkos Energy" SH.P.K ka filluar në të njëjtën kohë ndërtimin e HC Deçani, HC Belaje dhe HC Lumbardhi II, MMPH ka konsideruar se Leja Mjedisore dhe Certifikata e Përdorimit të lëshohet për të tri këto hidrocentrale, si tërësi. HC Deçani dhe HC Belaje kanë përfunduar ndërtimin pothuajse në të njëjtën kohë, ndërsa HC Lumbardhi II për shkaqe teknike dhe të terrenit nuk ka arritur të përfundoj ndërtimin në periudhën e parashikuar. Për këtë edhe ka pasur ngecje që këto hidrocentrale të pajisen nga MMPH me Certifikatë të Përdorimit dhe njëkohësisht me Leje Mjedisore.
- Me 30.09.2019 Aplikuesi dorëzon në Rregullator dëshminë ("Forma e aplikimit për Leje Mjedisore") të cilën e ka dorëzuar në MMPH me datë 27.09.2019 për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar, për HC Belaje.
- Rregullatori, duke u bazuar në Nenin 5 paragrafin 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë konstaton se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, andaj edhe i lëshon licencë të **përkohshme** ndërmarrjes në fjalë, për periudhën e paraparë si në dispozitiv të këtij Vendimi, me kusht që ndërmarrja të sjell në Rregullator Lejen Mjedisore të Integruar, brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të këtij vendimi.
- Nëse i Licencuari brenda afatit të përcaktuar me pikën I të dispozitivit të këtij Vendimi e sjell në Rregullator Lejen Mjedisore të Integruar, atëherë Rregullatori do të rishqyrtoj afatin e



vlefshmërisë së kësaj licence për prodhim të energjisë elektrike dhe do të vendos në pajtim me Nenin 32 paragrafi 2.1 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

- Sipas Nenit 8.1 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrjet që aplikojnë për Licencim në Rregullator duhet të njoftojnë përmes gazetës palët e interesit se kanë dorëzuar një aplikacion në Rregullator për Licencë të prodhimit të energjisë elektrike dhe se ai aplikacion është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë ndonjë parregullsi të tij.
- Ndërmarrja "Kelkos Energy" SH.P.K, me 25.09.2019 ka publikuar njoftimin në gazetë për ndërtimin e HC Belaje, në pajtim me paragrafin e sipërpërmendur. Palët e interesit nuk kanë kundërshtuar këtë aplikacion.
- Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike dhe legjislacionin tjetër në fuqi, kështu që pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmimeve tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes "KelkosEnergy" SH.P.K, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes "KelkosEnergy" SH.P.K, dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sefiraj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar